



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3115/13 prot.

Datë 23.01.2026

V E N D I M

Nr. 129/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.01.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1754/2025, datë 27.11.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-54514-07-11-2025, me objekt: “Shërbim Interneti Linja Primare”, me fond limit 21,773,156.00 (njëzet e një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) **Lekë, pa TVSH**, zhvilluar me datë 29-09-2025 nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “MC Networking” SHPK me Nipt K72223007O me adresë: Njësia bashkiake nr 5, rruga Pjetër Bogdani, godina nr 3, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: IDENTITEK SHA me adresë: Rruga “Xhanfize Keko”, Ish TopografiaUshtarake,Tiranë”

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 27.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1754/2025, ku vendosi:

[...]

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “MC Networking” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-54514-07-11-2025, me objekt: “Shërbim Interneti Linja Primare”, me fond limit 21,773,156.00 (njëzet e një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) **Lekë, pa TVSH**, zhvilluar me datë 29-09-2025 nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MC Networking” Shpk.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën me nr. 1835/6 prot., datë 15.01.2026 me lëndë “Mbi zbatimin e vendimit nr. 1745/2025 për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim Interneti Linja Primare”, me numër reference: REF-54514-07-11-2025”, protokolluar me tonën me nr. 3115/10 prot., datë 19.01.2026 autoriteti kontraktor, ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik si vijon: “[...] Në zbatim të vendimit nr. 1754/2025 prot., datë 27.11.2025 (protokolluar me tonën nr. 1835 prot., datë 05.12.2025) të Komisionit të Prokurimit Publik, më 10.12.2025 u kthye për rivlerësim në sistemin elektronik të prokurimeve, procedura e prokurimit me objekt: “Shërbim Interneti Linja Primare”, me fond në vlerën prej: 21,773,156 (njëzet e një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, me afat të marrëveshjes kuadër 12 (dymbëdhjetë) muaj, me numër reference: REF-54514-07-11-2025 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave më datë 10.12.2025 ka realizuar procesin e rivlerësimit të ofertave nga ku ka rezultuar se operatori ekonomik i kualifikuar i pari “MC Networking” SHPK ka rezultuar me ofertë anomalisht të ulët. - Me shkresën nr. 1835/1 prot., datë 10.12.2025, me lëndë “Mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i është drejtuar operatorit ekonomik i kualifikuar i pari “MC Networking” shpk, argumentimin mbi ofertën anomalisht të ulët. Me shkresën protokolluar me tonën me nr. 1835/2 prot., datë 15.12.2025 me lëndë: “Kthim përgjigje kërkesës për shpjegim të ofertës anomalisht të ulët”, është paraqitur materiali me sqarimet dhe

argumentimet përkatëse mbi ofertën dhe analizën e çmimit nga “MC Networking” shpk. Me procesverbalin nr. 5 datë 19.12.2025 të KVO, rezulton se pas shqyrtimit dhe vlerësimit argumentat dhe shpjegimet e këtij operatori në lidhje me ofertën e paraqitur, u pranuan si të vlefshme dhe bindëse, si rrjedhojë operatori “MC Networking” shpk u kualifikuar dhe oferta e tij u pranua.

-Me shkresën nr. 1835/3 prot., datë 19.12.2025, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i ka kërkuar ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumentave provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij nenin, si dhe dokumentat e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Më datë 22.12.2025, operatori ekonomik “MC Networking” ka paraqitur pranë “Identitek” sha, dokumentacionin fizik (protokolluar me tonën me nr. 1835/4 prot., datë 22.12.2025), i cili u mor në shqyrtim nga KVO dhe rezultoi se dokumentacioni është në përputhje me atë të dorëzuar elektronikisht, por nuk janë paraqitur dokumentet që përmbushin kriteret e përcaktuara në DST.

-Me shkresën nr. 04 prot., datë 05.01.2026, Gjykata Administrative e Apelit ka njoftuar nëpërmjet shkresës për “njoftim marrje mase sigurimi padie” nga operatori ekonomik “One Albania” SHA kundër vendimit të KPP në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “shërbim interneti linja primare”. Si pasojë KVO i ka dërguar emaili APP tek Info@app.gov.al për asistencë nëse duhet të vijohet me pezullim apo vlerësim të procedurës. Bazuar në përgjigjen e APP datë 09.01.2026 KVO ka vijuar me vlerësimin e dokumentacionit fizik [...]”.

II.3. Me shkresën me datë 15.01.2026 me lëndë “Kërkesë për marrjen e masave administrative ndaj zyrtarëve të autoritetit kontraktor Identitek SHA dhe moslejimin e vijimit të procedurës”, protokolluar me tonën me nr. 137 prot., datë 16.01.2025 operatori ekonomik “Mc Networking” SHPK ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik si vijon: “[...] Pas dorëzimit të dokumentacionit fizik nga OE, rezulton se nga ana e AK jo vetëm që nuk u ndërmor asnjë masë për zbatimin e vendimit, por se, pasi nga OE u dorëzua dokumentacioni fizik sipas kërkesave të AK (i njëjti që ishte hedhur në sistem dhe për të cilin ishte shprehur KPP), OE Mc Netëorking u s’kualifikua përsëri me të njëjtin arsyetim që ishte s’kualifikuar edge herën e parë, vendim i cili u shfuqizua nga ana e KPP-së me vendimin e sipërcituar. Më konkretisht shkaqet e s’kualifikimit të publikuara në sistem janë [...]”

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën me nr. 1835/6 prot., datë 15.01.2026 me lëndë “Mbi zbatimin e vendimit nr. 1745/2025 për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim Interneti Linja Primare”, me numër reference: REF-54514-07-11-2025”, protokolluar me tonën me nr. 3115/10 prot., datë 19.01.2026 autoriteti kontraktor, ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik si vijon: “[...] Në zbatim të vendimit nr. 1754/2025 prot., datë 27.11.2025 (protokolluar me tonën nr. 1835 prot., datë 05.12.2025) të Komisionit të Prokurimit Publik, më 10.12.2025 u kthye për rivlerësim në sistemin elektronik të prokurimeve, procedura e prokurimit me objekt: “Shërbim Interneti Linja Primare”, me fond në vlerën prej: 21,773,156 (njëzet e një milion e shtatëqind e shtatë dhjetë e tre mijë e

njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, me afat të marrëveshjes kuadër 12 (dymbëdhjetë) muaj, me numër reference: REF-54514-07-11-2025 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave më datë 10.12.2025 ka realizuar procesin e rivlerësimit të ofertave nga ku ka rezultuar se operatori ekonomik i kualifikuar i pari “MC Networking” SHPK ka rezultuar me ofertë anomalisht të ulët.

- Me shkresën nr. 1835/1 prot., datë 10.12.2025, me lëndë “Mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i është drejtuar operatorit ekonomik i kualifikuar i pari “MC Networking” shpk, argumentimin mbi ofertën anomalisht të ulët. Me shkresën protokolluar me tonën me nr. 1835/2 prot., datë 15.12.2025 me lëndë: “Kthim përgjigje kërkesës për shpjegim të ofertës anomalisht të ulët”, është paraqitur materiali me sqarimet dhe argumentimet përkatëse mbi ofertën dhe analizën e çmimit nga “MC Networking” shpk. Me procesverbalin nr. 5 datë 19.12.2025 të KVO, rezulton se pas shqyrtimit dhe vlerësimit argumentat dhe shpjegimet e këtij operatori në lidhje me ofertën e paraqitur, u pranuan si të vlefshme dhe bindëse, si rrjedhojë operatori “MC Networking” shpk u kualifikuar dhe oferta e tij u pranua.

-Me shkresën nr. 1835/3 prot., datë 19.12.2025, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i ka kërkuar ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumentave provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij nenin, si dhe dokumentat e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Më datë 22.12.2025, operatori ekonomik “MC Networking” ka paraqitur pranë “Identitek” sha, dokumentacionin fizik (protokolluar me tonën me nr. 1835/4 prot., datë 22.12.2025), i cili u mor në shqyrtim nga KVO dhe rezultoi se dokumentacioni është në përputhje me atë të dorëzuar elektronikisht, por nuk janë paraqitur dokumentet që përmbushin kriteret e përcaktuara në DST.

-Me shkresën nr. 04 prot., datë 05.01.2026, Gjykata Administrative e Apelit ka njoftuar nëpërmjet shkresës për “njoftim marrje mase sigurimi padie” nga operatori ekonomik “One Albania” SHA kundër vendimit të KPP në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “shërbim interneti linja primare”. Si pasojë KVO i ka dërguar emaili APP tek Info@app.gov.al për asistencë nëse duhet të vijohet me pezullim apo vlerësim të procedurës. Bazuar në përgjigjen e APP datë 09.01.2026 KVO ka vijuar me vlerësimin e dokumentacionit fizik [...]”.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, si dhe nga verifikimi i kryer në SPE, Komisioni konstaton, se në datë 14.01.2026 autoriteti kontraktor Identitek SHA ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit në SPE.

Operatori ekonomik “Mc Networking” SHPK, rezulton i skualifikuar me arsyetimin si vijon: “...nuk janë paraqitur dokumentet që përmbushin e mbështesin pikën 2.2 të kriterëve të DST, të kapacitetit ekonomik dhe financiar ku citohet: “Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit” - Bilanci i paraqitur i vitit 2022 me nr. 4384 prot., datë 06.03.2024, nuk ka vulën nga Drejtoria Rajonale Tatimore në asnjë nga faqet e tij. - Gjithashtu Bilanci i vitit 2024 me nr. 9623 prot., datë 12.05.2025, i mungon vula nga Drejtoria Rajonale Tatimore në faqen nr.3 të tij. Bazuar në Nenin 49 të LIGJIT Nr. 44/2015 KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE I REPUBLIKËS SHQIPËRISË (i ndryshuar) Njësimi i akteve të veta 1..... 2. Njësimi me origjinalin nuk bëhet nëse, sipas rrethanave, rezulton

se origjinali përmban ndryshime, mospërputhje, fshirje, fjalë, figura ose shenja të palexueshme, gjurmë të fshirjes së tyre, ose kur vazhdimësia e dokumentit të përbërë nga disa fletë është ndërprerë. 4. Njësimi me origjinalin bëhet nëpërmjet vendosjes së shënimit të njësimit në fund të kopjes. Ky shënim duhet të përmbajë: a).... ç) organin publik që bën njësimin dhe vulën e tij zyrtare;.... Për rrjedhojë, KVO arsyeton se mungesa e vulës tatimore bën që bilancet mos të konsiderohen të vlefshme dhe në përmbushje të kriterit, pavarësisht se shkresa përcjellëse ka vulë tatimore. Certifikimi i balanceve vërtetohet nëpërmjet vulës nga DRT në çdo faqe të tij”

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, jo në përputhje me pikën III.1.6 të vendimit nr. 1754/2025, datë 27.11.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, ku Komisioni është shprehur si vijon: “[...] Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik “MC Networking” SHPK me arsyetimin se: “Bilanci i paraqitur i vitit 2022 me nr. 4384 prot., datë 06.03.2024, nuk ka vulën nga Drejtoria Rajonale Tatimore në asnjë nga faqet e tij. Gjithashtu Bilanci i vitit 2024 me nr. 9623 prot., datë 12.05.2025, i mungon vula nga Drejtoria Rajonale Tatimore në faqen nr.3 të tij. Për rrjedhojë mungesa e vulës tatimore bën që bilancet mos të konsiderohen të vlefshme dhe në përmbushje të kriterit. Sa më sipër, kjo ofertë vlerësohet të refuzohet dhe operatori ekonomik të skualifikohet, bazuar edhe në nenet 80 e 92 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe nenin 82 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2023 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Për këtë arsye, operatori ekonomik “MC NETWORKING” SHPK Nuk kualifikohet”, si dhe nga verifikimi i dokumentave të tenderit Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në pikën 2.2.2 të shtojcës nr. 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon: “2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të balanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”. Në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur operatori ekonomik “Mc Networking” SHPK ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si vijon: Raport Auditimi për pasqyrat financiare të shoqërisë MC Networking sh.p.k për periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2022. Shkresën me nr. 4384 prot., datë 06.03.2024 me lëndë “Kthim përgjigje”, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me përmbajtje si vijon: “Në përgjigje të kërkesës tuaj me numër çështje E0001220388 datë 05.03.2024, po ju vëmë në dispozicion në formatin PDF, kopje të pasqyrave financiare të depozituara nga ana juaj, në sistemin informatik tatimor, për vitet: Viti 2022 të dorëzuara elektronikisht pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me datë 16.01.2024”. Bashkëlidhur kopje e pasqyrave financiare. Raport Auditimi për pasqyrat financiare të shoqërisë MC Networking sh.p.k për periudhën nga 1 janari 2023 deri më 31 dhjetor 2023.

Shkresën me nr. 9021 prot., datë 08.05.2024 me lëndë “Kthim përgjigje”, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me përmbajtje si vijon: “Në përgjigje të kërkesës tuaj me numër çështje E0001249644 datë 08.05.2024, po ju vëmë në dispozicion në formatin PDF, kopje të pasqyrave financiare të depozituara nga ana juaj, në sistemin informatik tatimor, për vitet: Viti 2023 të dorëzuara elektronikisht pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me datë 07.05.2024”. Bashkëlidhur kopje e pasqyrave financiare

Raport Auditimi për pasqyrat financiare të shoqërisë MC Networking sh.p.k për periudhën nga 1 janari 2024 deri më 31 dhjetor 2024. Shkresën me nr. 9623 prot., datë 12.05.2025 me lëndë “Kthim përgjigje”, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me përmbajtje si vijon: “Në

përgjigje të kërkesës tuaj me numër çështje E0001425378 datë 11.05.2024, po ju vëmë në dispozicion në formatin PDF, kopje të pasqyrave financiare të depozituara nga ana juaj, në sistemin informatik tatimor, për vitet: Viti 2024 të dorëzuara elektronikisht pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me datë 11.05.2024”. Bashkëlidhur kopje e pasqyrave financiare. Pra nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ka dorëzuar kopje të balanceve për vitin 2022, 2023, 2024 të shoqëruar nga shkresa e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Tiranë. Në këto kushte Komisioni gjykon, se operatori ekonomik “MC Networking” SHPK ka dhënë një indicie që përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, pikën 2.2.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi bilanci të dorëzuar janë të shoqëruara nga shkresa e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Tiranë. Nëse autoriteti kontraktor kishte dyshime lidhur me dokumentacionin e dorëzuar mund të kryente verifikime të mëtejshme apo ti kërkonte sqarime operatorit ekonomik në përputhje me nenin 92 të LPP-së”. KPP ju sjell dhe një herë në vëmendje se në cilësinë e organit më të lartë në fushën e prokurimeve siguron zbatimin me përpikmëri të dispozitave ligjore në lidhje me prokurimin publik për të cilën shprehet me vendimarrje që është e detyrueshme për tu zbatuar nga autoritetet kontraktore. Në rastin konkret autoriteti kontraktor duhet të masa për zbatimin plotësisht të vendimit nr. 1754/2025, datë 27.11.2025. Komisioni gjykon, se lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Mc Networking” SHPK nga KVO-ja si më sipër cituar, autoriteti kontraktor ka kryer verifikimin dhe vlerësimin e tyre në fazën e parë të vlerësimit të ofertave dhe ka patur në dispozicion momentin procedural për të kryer verifikime apo për të kërkuar sqarime lidhur me dokumentacionin e ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik ankimues.

II.3 Sa më sipër Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor Identitek SHA duhet të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në përputhje me vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1754/2025, datë 27.11.2025.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-54514-07-11-2025, me objekt: “Shërbim Interneti Linja Primare”, me fond limit 21,773,156.00 (njëzet e një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) **Lekë, pa TVSH**, zhvilluar me datë 29-09-2025 nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të zbatojë plotësisht vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1754/2025, datë 27.11.2025.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

